



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1350/14 Prot.

Tiranë, më 24.02 2025

UDHËZIM

Nr. 12, Datë 24.02.2025

PËR

DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 22.07.2024 "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË PUNONJËSVE ARSIMORË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 59 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", i ndryshuar bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Shkronja "a", e pikës 1, të nenit 17, të kreut III, bëhet ndryshimi si më poshtë:

"a) Licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit, në profilin përkatës.

Mësuesit që janë përjashtuar nga detyrimi i provimit të shtetit, ngarkojnë diplomë në fushën e mësuesisë ose diploma të arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë ose të barasvlershme me to, të ngjashme ose të përafërta me fushën përkatëse të mesindhënies në arsimin parauniversitar, përfshirë edhe diplomat e kandidatëve që japin lëndët e muzikës, të arteve pamore, kërcimit dhe edukimi fizik.

Mësuesit nëse kanë, ngarkojnë edhe:

- i. Diplomë të ciklit të dytë master me 60–120 kredite, e cila nuk është diplomë që vlen si kriter arsimimi për profesionin e mësuesit;*
- ii. Diplomë të ciklit të tretë "Master ekzekutiv" ose të barasvlershme me to me 60–120 kredite;*
- iii. Diplomë për fitimin e gradës shkencore "Doktor" në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës.*

b) Shkronja "b" e shtojcës nr. 5 ndryshon si më poshtë:

"b) Diplomë: Diplomë e ciklit të dytë master me 60-120 kredite ECTS, diplomat e ciklit të tretë "Master ekzekutiv" ose të barasvlershme me to me 60-120 kredite ECTS, doktoratë të fituar në fushën e edukimit, të drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës.

Kjo lloj diplome nuk përfiton pikë shtesë nëse vlen si kriter shkollimi për profesionin e mësuesit.

- 1) Diploma me 60-90 kredite, vlerësohen me 8 pikë.
- 2) Diploma me 120 kredite, vlerësohen me 9 pikë.
- 3) Doktoraturë, vlerësohet me 10 pikë."

c) Togfjalëshi në kolonën e pikëzimit që i përket shkronjës "b" të shtojcës nr. 5, ndryshon "nga 5-10 pikë" në "8-10 pikë".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

